

BIOGRAFIA

Marija Radulović

E lindur më 25 prill 1985, në Kragujevc (Serbi), ku mbaroi shkollën fillore dhe të mesme.

Në vitin 2004 i regjistroi studimet në katedrën e gjuhës dhe letërsisë arabe në Fakultetin Filologjik në Beograd, të cilat i përfundoi në vitin 2008. Në fakultetin në fjalë ajo përfundoi edhe studimet master në vitin 2009, ku u mor me studimin e civilizimit dhe kulturës arabe. Në vitin 2011, i regjistroi studimet master në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Beogradit, të cilat i përfundoi në shkurt të vitit 2013.

Ajo ka përfunduar gjithashtu një numër të trajnimeve dhe kurseve profesionale, si: Akademia „Friedrich Ebert Stiftung”, Public Policy Development and Leadership program, training “Good Governance” të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hungarisë dhe të tjera. Ajo ka qëndruar në vizitat studimore në institucionet e Bashkimit Evropian në Strasburg dhe Bruksel, si dhe në institucionet e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë dhe Vjenë.

Nga viti 2009 deri në vitin 2011 ka punuar në Ambasadën e Palestinës në Beograd, në cilësinë e zyrtares për media dhe protokoll.

Nga viti 2011 deri në vitin 2014 ka punuar në Ministrinë e Pushtetit Lokal në cilësinë e këshilltares së Ministrit.

Nga viti 2014 deri në vitin 2018 ka punuar në Gjykatën Kushtetuese si redaktore e lëndëve në gjuhën serbe.

Në janar të vitit 2018 u zgjodh zëvendëse e Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve jo-shumicë.

Ajo e flet rrjedhshëm gjuhën arabe dhe angleze dhe e njeh shumë mirë gjuhën shqipe.